



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2022:181320
Datë: 26.02.2025
Numri i dokumentit: 06904971

C.nr. 777/2022

GJYKATA THEMELORE GJILAN – DEGA VITI, gjyqtari Arben Xheladini, në çështjen juridike kontestimore të paditësve, D.M., F.M., dhe N.M, nga V., Rr. “M.M.” nr... të cilët sipas autorizimit i përfaqëson, Zyre Avokatie “B&B” me seli në Gjilan, kundër të paditurit R.M., nga V.. Rr. “M.M.” nr..., i përfaqësuar me autorizim nga Ekrem Pira avokat në Viti, dhe të paditurit M.C., nga Vitia, tani me adresë të panjohur në R. e S., i përfaqësuar nga përfaqësuesi i përkohshëm, Sherif Sherifi, avokat në Viti, me objekt kontesti vërtetimi i të drejtës së pronësisë në bazë të shitblerjes, vlera e kontestit 50, 000 Euro, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor dhe publik më datë 12.02.2025, në të njejtën ditë mori dhe shpalli këtë:

AKTGJYKIM NË BAZË TË POHIMIT

I. Vërtetohet se paditësit, D.M., F.M., dhe N.M, janë pronarë me nga $\frac{1}{4}$ të ngastrës 1986-2, me sipërfaqe të përgjithshme grafike prej 4371 m², në vendin e quajtur “G..”, ZK Viti, e evidentuar në emër të të paditurit R.M., e cila në pjesën veriore kufizohet me parcelën 3619-0, nga pika a deri në pikën b, në distancë prej 26.19 m, në lindje me parcelën 1987-1, nga pika b në pikën c, në distancë 17.44 m, në jug me parcelën 1985-0, nga pika c në pikën ç, në distancë 20.12 m, dhe nga pika ç në pikën d, në distancë prej 4.97 m, në perëndim kufizohet me parcelën 1986-5, nga pika d deri në pikën a, në distancë prej 16.61 m.

II. Konstatohet e tërhequr padia e paditësve, D.M., F.M., dhe N.M, kundër të paditurit, M.C.,

III. Paditësit i bartin shpenzimet e veta të procedurës, ndërsa detyrohen që, në mënyrë solidare, të paditurit R.M., në emër të shpenzimeve të procedurës t’ia paguajnë shumën prej 1080 Euro, dhe përfaqësuesit të përkohshëm, Av. Sherif Sherifi shumën prej 644 Euro, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të aktgjykimit, nën kërcënim të përbarimit.

Arsyetim

Më datë 05.09.2022, paditësit, përmes përfaqësuesit me autorizim, kanë paraqitur padi kundër të paditurit, R.M., me objekt të kontestit vërtetimi i të drejtës së pronësisë me pretendimin se paditësit dhe i padituri, janë në posedim dhe shfrytëzim me nga $\frac{1}{4}$ të parcelës 1986-2, ku e kanë të ndërtuar shtëpinë dhe secili jeton në hyrje të veçantë. Se këtë parcelë, paditësit së bashku me babanë e tyre dhe të paditurin në vitin 1985 e kishin blerë nga R.Z., dhe, sipas marrëveshjes për ndarjen e bashkësisë ekonomike familjare, të gjithë ishin pajtuar që parcela të regjistrohej vetëm në

emër të të paditurit, ndërsa i padituri nuk ua ka bartur paditësve pjesët që iu takojnë. Pretendimet lidhur me paluajtshmërinë si në padi, i autorizuari i paditësive i ka përsëritur edhe në seancën përgatitore, e në këtë seancë, e ka ndryshuar padinë në kuptimin objektiv dhe subjektiv, duke e paditur edhe M.C., dhe ka kërkuar vërtetimin e pronësisë edhe në parcelën 01986-3. Pas administrimit të provave materiale, përfaqësuesi i paditësve, e ka tërhequr padinë kundër të paditurit, M.C.,

Lidhur me parcelën 1986-2, pas saktësimit të kërkesëpadisë, ka propozuar që gjykata të nxjerrë aktgjykim në bazë të pohimit meqë i padituri R.M., nuk e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësve, e as propozimin për dhënien e aktgjykimit në bazë të pohimit.

I padituri, R.M., me përgjigje në padi, gjatë gjithë shqyrtimit të çështjes nuk e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësve, e as pas saktësimit të kërkesëpadisë me përmasa dhe kufij të parcelës, dhe ka propozuar që gjykata të nxjerrë aktgjykim në bazë të pohimit. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar të specifikuar me arsyetimin se në këtë procedurë ishte përfaqësuar nga avokati.

Sipas propozimit të përfaqësuesit të paditësve, gjykata e ka caktuar avoaktin Sherif Sherifi përfaqësues të përkohshëm të të paditurit, M.C., i cili me përgjigje në padi dhe gjatë shqyrtimit kryesor të çështjes, e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësve, me arsyetimin se me asnjë provë nuk e kanë mbështetur pretendimet e tyre. Ndërsa, nuk e ka kundërshtuar tërheqjen e padisë kundër të paditurit, në seancën e datës 12.02.2025. shpenzimet e procedurës i ka kërkuar të specifikuar.

Gjykata, sipas propozimit të paditësve, gjatë shqyrtimit kryesor të çështjes i ka admisnitruar provat materiale të propozuara, e po ashtu edhe ekspertizën gjeodezike.

Gjykata, pas pohimit të kërkesëpadisë nga i padituri, ka vërtetuar se kërkesat janë të disponueshme për palët, andaj, në kuptim të nenit 148 par 1 të LPK-së i cili përcakton se: “në qoftë se i padituri deri në përfundim të çështjes e pohon kërkesëpadinë pjesërisht apo tërësisht gjykata jep pa shqyrtim të mëtejme në të cilin aprovon pjesën apo gjithë kërkesëpadinë (Aktgjykim në baze të Pohimit)”, meqë i padituri mund të disponoj me deklaratën e pohimit pasi është pronar i parcelës 1986-2, me sipërfaqe të përgjithshme grafike prej 4371 m², të vërtetuar me ekspertizën e gjeodezisë.

Gjykata e ka konstatuar tërhequr padinë si në pikën II, duke u bazuar në nenin 261 të LPK-së meqë përfaqësuesi i përkohshëm nuk e kundërshtuar.

Paditësi i bartë shpenzimet e veta të procedurës meqë nuk i kërkoi. Gjykata, kërkesën për shpenzime të procedurës të të paditurit R.M., dhe përfaqësuesit të përkohshëm e miratoi si në pikën II të dispozitivit, pasi ishin të specifikuar sipas nenit 463 të LPK-së, edhe atë për të paditurin e parë për katër seanca secila nga 270 Euro shumën e përgjithshme 1080 Euro, ndërsa për përfaqësuesin e përkohshëm për përpilim të përgjigjes në padi 104 Euro dhe për katër seanca secila nga 135 Euro, në shumë të përgjithshme 644 Euro sipas Rregullores për Tarifa të OAK, numri tarifar 6 dhe 7. Para fillimit të shqyrtimit të çështjes, për pagimin shpenzimeve përfaqësuesit të përkohshëm, paditësit e ka deponuar shumën prej 717 Euro, ashtu që shuma 73 Euro e mbetur nga depozita civile, do t'iu kthehet paditësve.

Nga të lartcekurat, e bazuar në nenin 2 lidhur me nenin 142 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJILAN DEGA VITI
C.nr.777/2022, datë 12.02.2025

Gjyqtari,

Arben Xheladini

Këshillë Juridike:

Kundër pikës I dhe II të dispozitivit të aktgjykimit, është e lejuar ankesa në Gjykatën e Apelit, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimet të aktgjykimit. Ankesa, në kopje të mjaftueshme, dorëzohet në këtë gjykatë.

Kundër pikës II të dispozitivit nuk është e lejuar ankesa.